



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 65, datë 04.07.2018

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "R&T" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):

"R&T" Shpk me NIPT J61901094G, me adresë: "Rr. Luigj Gurakuqi, Pall. 89, Shk. A, Kati 10", Tiranë.

II. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "R&T" Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 1531 Prot., datë 21.02.2018, të dërguar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, me të cilën ky i fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "R&T" Shpk, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për keqinformim dhe paraqitje të dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit dhe paraqitjes së dokumentave që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 13/3/a të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr. 65, datë 04.07.2018 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare operatorin ekonomik "R&T" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, **nga hyrja në fuqi e këtij vendimi**, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që operatori ekonomik "R&T" Shpk është skualifikuar nga procedura e prokurimit dhe nuk ka përfutur fondet publike të saj, si dhe faktin që ky operator ekonomik nuk ka qenë i përjashtuar më parë nga pjesëmarrja në prokurimet publike.